



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.133/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bektishi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lidhjes Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 2,300.00 (dymjë e treqind) euro, të cilën i njëjti detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datë 29.09.2019, Lidhja Demokratike e Kosovës ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 28 Shtator 2019 rreth orës 15:00, zyrtarë të Shtabit Zgjedhor të LDK-së në Viti, kanë vërejtur dhe fotografuar vendosjen e një foto-posteri të kandidatit për deputet Fahrush Azemi, për qëllime elektorale nga subjekti politik PDK, për çka LDK ka marrë vesh se subjekti PDK nuk ka marr pëlqimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vendosjen e foto-posterëve nëpër rrugë publike, në këtë formë, është vepruar në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së dhe rregullën zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013 të KQZ-së. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se duke marrë parasysh qartësinë e kërkesës së dispozitës 33 pika b) e LPZ-së, i drejtohami organit tuaj me kërkesën që subjektit politik PDK t'i shqiptohet masa e sanksionit konform nenit 3.2 të rregullës së PZAP-it. Si dëshmi për pretendimet e tona i kemi bashkangjitur ankesës fotografitë.

Në përgjigje në ankesë të datës 30.09.2019, subjekti politik PDK, konsideron se shkelja nuk është e qëllimshme, pasi që aktivista të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore vendosin postera ende pa e marrë pëlqimin me shkrim, edhe pse zyrtar nga Komuna e Vitisë gojarisht i kanë konfirmuar zyrtarëve të partisë se vendi është i dedikuar për postera. Më tutje në përgjigje subjekti politik PDK, thekson se kemi marrë masat përmirësuese duke i larguar posterat, si dëshmi për pretendimet tona i kemi bashkangjitur fotot ku shihet largimi i posterave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se subjekti politik i ka vendosur posteret e e kandidatit të tyre Fahrush Azemi në vendin e dedikuar për posterë por pa sigurra paraprakish pëlqimin nga Komuna e Vitisë, , veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “*Veprime e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakatave dhe posterave, vendosja e emrave te tyre ose sloganeve ne lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut etj*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik kanë qenë i njofuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, sepse ka marr pjesë në zgjedhjet e mëhershme;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret, duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtë janë të njofuar me rregullat zgjedhore, po ashtu si rrethanë tjetër, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur, madje i njëjti subjekt ka vepruar drejtë përmirësimit të shkeljes sepse ka larguar posteratë në fjalë , veprim ky i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me anë të këtij vendimi respektivisht gjobës së shqiptuar paneli synon të ndikon te subjekti politik që në të ardhmen ky subjekt mos t'i përsërit veprimet e njëjta apo veprime tjera të cilat bien ndesh me ligjin.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesë janë të pabazuar, dhe nuk përbëjnë shkelje te nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posterat e subjektit politik PDK, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterave.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**  
Anr.133/2019 më datën 02.10.2019

**Kryesues i Panelit**

Faton Ademi



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.